



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT



Nr. 53/5 prot.

Vlorë, më 28.02.2019

Lënda: Përcjellje e sistemit të pikëzimit për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë
Prof. Dr. Albert Qarri

Bazuar në Shkresën “Përcjellje Urdhëri” Nr. 275/4 Prot., dt. 26.02.2019 të Drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore si dhe shkresës “Urdhër” Nr. 15 dt. 26.02.2019 me nr 275/3 Prot, datë 26.02.2019 të Rektorit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, “Për ngritjen e komisionit ad- hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të pjesshëm, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë”, në zbatim të **Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”**, Neni 64 “Punësimi i personelit akademik”, pika 1, bazuar në Nenin nr. 44 të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë si dhe në pikën 3 të nenit 29 të Rregullores së Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në mbledhjen e datës 11.02.2019 me këtë temë në Departamentin e Ekonomiksit, sikurse edhe përcjellë më parë përmes shkresës “Përcjellje e kërsekave për punësim si dhe kriterëve për punësim” Nr. Prot. 53/1, dt. 11.02.2019 nga Drejtuesi i Departamentit të Ekonomiksit, përcjellë me Shkresë Përcjellëse me Nr. 53/2 dt. 12.02.2019 nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, në vijim Ju përcjell sistemin e pikëzimit, për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme:

Sistemi i pikëzimit për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve:

- Në fazën e parë bëhet vlerësimi me pikë duke ju referuar rezultateve të shkollimit për çdo diplomë që zoteron kandidati, eksperiencës në mësimdhënie, aktivitetit shkencor, studimeve të ciklit të tretë, gradës shkencore dhe titujve akademikë si më poshtë:

Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL në Shqipëri:

- Për diplomën “Bachelor” 0,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9 -10.
- Për diplomën “4-vjeçare” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT

- Për diplomën “5-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “Master i Shkencave” apo “Master i Nivelit të Dytë” 0.5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.

○

Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë të fituar në universitetet perëndimore:

- Për diplomën “Bachelor” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “4-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “5-vjeçare” 1,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “Master i Shkencave” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.

Eksperienca në mësimdhënie në IAL në Shqipëri:

- Me kohë të plotë 1 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 5 pikë në total.
- Me kohë të pjesshme 0,5 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 2 pikë në total.

Aktiviteti shkencor:

- Botime në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti 5 pikë çdo artikull.
- Botime në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial 2 pikë çdo artikull.

Grada Shkencore dhe tituj akademikë:

- Doktor i Shkencave 50 pikë.
- Profesor i Asociuar 100 pikë,
- PhD në universitetet perëndimore 100 pikë.
- Profesor Doktor 150 pikë

Komisionet ad-hoc janë përgjegjëse për respektimin e kritereve dhe për procedurën e konkurimit. Këto komisione në çdo rast kanë të drejtë të kërkojnë dokumentacion shtesë për vërtetësinë e dosjes dhe të deklarimeve.

Drejtuese e Departamentit të Ekonomiksit
Dr. Klaudja Guga

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje